



TAKIMI IV VJETOR NDËRKOMBËTAR I INSTITUTIT ALB-SHKENCA

Shkup - Tetovë, 30 gusht – 2 shtator 2009



PRISHTINË



SHKUP



TIRANË

STUDIUESIT SHQIPTARË NË RRJEDHAT E SHKENCËS BOTËRORE

Thirrje për pjesëmarrje

drejtuar anëtarëve të IASH-së si dhe studiuesve të tjerë të interesuar
E nderuara Kolege / I nderuar Koleg

kemi kënaqësinë t'ju ftojmë të merrni pjesë në Takimin IV Vjetor Ndërkombëtar të Institutit Alb-Shkenca (Shkup-Tetovë, 30 gusht - 2 shtator 2009).

Takimet e përvitshme të Institutit shërbejnë për të paraqitur arritjet më të reja shkencore të anëtarëve të IASH-së e të studiuesve të tjerë si dhe për të nxitur bashkëpunimin midis shkencëtarëve shqiptarë kudo që ndodhen.

Përveç kësaj, këto takime kanë si qëllim edhe krijimin e një terreni të përshtatshëm për forcimin e lidhjeve ndërmjet universiteteve dhe institucioneve akademike e shkencore, shqiptare e të huaja, përmes projekteve të përbashkëta.

Takimi i sivjetëm organizohet në bashkëpunim me Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL) në Tetovë dhe me përkrahjen financiare të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Tema bosht e Takimit IV do të jetë: **"Studiuesit shqiptarë në rrjedhat e shkencës botërore"**. Do të mbahen tetë konferenca shkencore (një për secilin seksion shkencor të IASH-së) dhe një konferencë informuese mbi mundësitë e aplikimeve dhe bashkëpunimeve në projekte ndërkombëtare. Në kuadër të secilës konferencë do të organizohen disa simpoziume. Takimit do t'i paraprijë një seancë e veçantë me temë: **"Institucionet akademike dhe shkencore: përvojat e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë"**.

Kumtimet mund të mbahen në gjuhën shqipe ose në atë angleze. Nga të ftuarit parashi-het të mbahen ligjërata, paraqitje gojore dhe me postera.

MBËSHTETËS TË TAKIMIT: UNIVERSITETI I EUROPËS JUGLINDORE
DHE QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



KOMITETI ORGANIZUES I TAKIMIT IV VJETOR NDËRKOMBËTAR TË INSTITUTIT ALB-SHKENCA

Këshilli Organizues

- Zeqirja NEZIRI, *kryetar*
- Murtezan ISMAILI, *nënkryetar*
- Vebi BEXHETI, *nënkryetar*
- Asllan HAMITI, *anëtar*
- Arta SELMANI, *anëtare*
- Ajtene QAMILI, *anëtare*
- Besa ARIFI, *anëtar*
- Evan RROÇO, *anëtar*
- Gentjana TARE, *anëtare*
- Hamit XHAFFERI, *anëtar*
- Nikolla P. QAFOKU, *anëtar*
- Mentor HAMITI, *anëtar*
- Mustafa IBRAHIMI, *anëtar*
- Vjollca ISTREFI, *anëtare*

Këshilli Shkencor

- Ali CAKA (Kosovë)
- Arben MERKOÇI (Spanjë)
- **Ardiana GASHI (Prishtinë)**
- Ardian HARRI (SHBA)
Kryetar i Seksionit të Ekonomisë
- Ardian MAÇI (Shqipëri)
- Avdullah HOTI (Kosovë)
- Bajram BERISHA (Gjermani)
- Begzad BALIU (Kosovë)
Kryetar i Seksionit të Albanologjisë
- Besnik DOBI (Shqipëri)
- Burim KAMISHI (Kosovë)
- Edlira F. MULLA (Shqipëri)
- Eshref JANUZAJ (Gjermani)
- Evan RROÇO (Shqipëri)

- Fatos OLLDASHI (Shqipëri)
- Fatos YLLI (Shqipëri)
- Gentian ZYBERI (Holandë)
Kryetar i Seksionit të Drejtësisë
- Jahja KOKAJ (Kuvajt)
- Kristaq JORGO (Shqipëri)
- LLuka P. QAFOKU (Shqipëri)
- Lindita KOMANI (Austri)
- Lulzim DRAGIDELLA (Gjermani)
Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Politike
- Mimoza KOKA (Shqipëri)
- Mirela BOGDANI (Angli)
- Musa RIZAJ (Kosovë)
Kryetar i Seksionit të Inxhinierisë dhe Informatikës
- Naim SHABANI (Gjermani)
Kryetar i Seksionit të Mjekësisë
- Naser RAMADANI (Kosovë)
- Nebi CAKA (Kosovë)
- Nikolla P. QAFOKU (SHBA)
Kryetar i Seksionit të Bujqësisë dhe Mjedisit
- Pandi ZDRULI (Itali)
- Petraq PAPAJORGJI (SHBA)
- Petrit ZORBA (Shqipëri)
- Ramadan JASHARI (Belgjike)
- Robert MAGARI (SHBA)
Kryetar i Seksionit të Shkencave të Natyrës
- Roza ALLABASHI (Austri)
- Zeqirja NEZIRI (Maqedoni)

Data me rëndësi

Dërgimi i titullit dhe i përmbledhjes së kumtimit:

31 maj 2009

Shpallja e përmbledhjeve/abstrakteve të miratuara:

30 qershor 2009

Regjistrimi (për anëtarët e IASH-së 10 euro, për të tjerët 35 euro):

31 korrik 2009

Regjistrimi (për anëtarët e IASH-së 10 euro, për të tjerët 70 euro):

31 gusht 2009

Afati

Pagesa bëhet pranë degëve gjeografike të Institutit Alb-Shkenca në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup. Pyetjet që mund të keni ju lutemi dërgojini në adresën tv2009@alb-shkenca.org ose kontaktoni me kryetarët e qëndrave gjeografike të Institutit: Ardian Maçi (Tiranë), ardianmaci2003@yahoo.com; Begzad Baliu (Prishtinë), bbaliu@yahoo.com; Zeqirja Neziri (Shkup), zekoneziri@yahoo.com.



KONFERENCAT SHKENCORE NË KUADËR TË TAKIMIT TË KATËRT

- I. Konferenca e Seksionit të Shkencave Albanologjike
- II. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Drejtësisë
- III. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Bujqësisë dhe të Mjedisit
- IV. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Ekonomisë
- V. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Natyrës
- VI. Konferenca e Seksionit të Shkencave të Mjekësisë
- VII. Konferenca e Seksionit të Shkencave Inxhinierike dhe të Teknologjisë së Informacionit.
- VIII. Konferenca e Seksionit të Shkencave Shoqërore
- IX. Konferenca e projekteve ndërkombëtare

INFORMACIONE PËR TË INTERESUARIT

- Është e preferueshme që të interesuarit të paraqiten me arritjet më të reja nga fushat e angazhimeve të tyre profesionale – shkencore.
- Kumtesat / Ligjëratat duhet të jenë origjinale, të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi.
- Kusht i domosdoshëm për botimin e kontributit në revistën shkencore Aktet e Takimeve Ndërkombëtare Vjetore të Institutit Alb-Shkenca është pjesëmarrja në konferencë të paktën e njërit prej autorëve (në rastet kur kontributet janë me bashkautorësi).
- Deri në **31 maj 2009**, në adresën e seksionit përkatës, duhet të dërgohet titulli i kontributit me përmbledhjen (abstraktin) prej 150-250 fjalësh, sipas modelit që jepet më poshtë (**Formulari 1**).
- Shtyrja e afatit të dorëzimit të abstraktit është e pamundshme, sepse vonon procesin e botimeve të tyre në një libër të veçantë, i cili do të shpërndahet bashkë me revistën **“Aktet”** e dy Takimeve paraprake.
- Përmbledhjes së kontributit duhet t’i prijë shënimi se në cilin simpozium dëshironi ta paraqitni.
- Secili i interesuar është i lirë të përfaqësohet me më shumë se një kontribut (në konferenca/simpoziume të veçanta shkencore).
- Varianti për botim i kontributeve duhet të jetë në gjuhën shqipe ose angleze, i formatuar sipas rregullave të IASH-së, që do të dërgohen më vonë.
- Është mirë që të interesuarit të kontaktojnë me përgjegjësit për organizimin e konferencave.
- Në qoftë se dëshironi të ndihmoni në organizimin e konferencave /simpoziumeve dhe nëse kërkon informacion shtesë rreth Takimit IV të IASH-së ju lutemi të na shkruani në adresën: **tv2009@alb-shkenca.org**

www.alb-shkenca.org



KONFERENCAT SHKENCORE

Grupet e punës për organizimin e konferencave janë të hapur për ndihmë dhe bashkëpunim.

I. Konferencat e Seksionit të Shkencave Albanologjike

Përgjegjës: Begzad BALIU (Prishtinë), Kristaq JORGO (Tiranë) dhe Zeqirja NEZIRI (Shkup)
Bashkëpunëtorë: Ali CAKA (Prishtinë), Asllan HAMITI (Shkup), Gentjana TARE (Vlorë), Hamit XHAFERI (Tetovë), Irena LAMA (Tiranë), Izaim MURTEZANI (Shkup), Laura SMAQI (Tiranë), Mustafa IBRAHIMI (Tetovë).

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: albanologjia09@alb-shkenca.org

Temat e simpoziumeve:

1. *Disiplinat albanologjike në shek. XXI: çështje të teorisë e të metodologjisë së studimit*
2. *Toponimia dhe antroponimia shqiptare sot - gjendja dhe perspektiva*
3. *Femra shqiptare në arte e shkenca*
4. *Letërsia shqipe në hapësira të reja gjuhësore: probleme të përkthimit*
5. *Profesor Selman Riza dhe gjuhësia shqiptare*
6. *Profesor Lorenc Antoni – pionier i etnomuzikologjisë shqiptare*
7. *Petro Zheji dhe albanologjia 'alternative'*

II. Konferencat e Seksionit të Shkencave të Drejtësisë

Përgjegjës: Gentian ZYBERI (Holandë)

Bashkëpunëtorë: Arta SELMANI (Tetovë), Besa ARIFI (Tetovë), Vjollca ISTREFI (Tetovë).

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: drejtësia09@alb-shkenca.org

Temat e simpoziumeve:

1. *Seancë plenare: Krimi, ligji, dhe shteti: Çështje lidhur me ushtrimin e përshtatshëm të forcës së shtetit*
2. *Mirëpriten punime në fushën e drejtësisë apo të karakterit ndërdisiplinore që fokusohen në tri nëntemat e mëposhtme:*
 2. 1. *Ligji, nacionaliteti dhe identiteti*
 2. 2. *Pikëtakimet e ligjit me çështje të zgjedhjes, përgjegjësisë dhe përgjegjësisë së kufizuar*
 2. 3. *Përgjegjësia shtetërore për terrorizëm, luftë, ndërhyrje, spastrim etnik dhe probleme të tjera të së drejtës ndërkombëtare e të marrëdhënieve ndërkombëtare*

III. Konferencat e Seksionit të Shkencave të Bujqësisë dhe të Mjedisit

Përgjegjës: Nikolla P. QAFOKU (SHBA), Namik DURMISHI (Tetovë), Roza ALLABASHI (Austri), Edlira F. MULLA (Tiranë).

Bashkëpunëtorë: Ardian MAÇI (Tiranë), Evan RROÇO (Tiranë), Pandi ZDRULI (Itali), Petrit ZORBA (Tiranë).

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: bujqesia09@alb-shkenca.org

Temat e simpoziumeve:

Temat e simpoziumeve në këtë Konferencë, me përjashtim të atyre të shkencave të mjedisit, do të përcaktohen pas marrjes së përmbledhjeve të prezantimeve. Do të pranohen përmbledhje me temë nga të gjitha fushat e këtij seksioni (bujqësi, veterinar, zooteknikë,

pyje dhe mbrojtje e mjedisit).

Në fushën e shkencave të mjedisit do të organizohen simpoziumet e mëposhtme:

1. *Cilësia e ajrit dhe ndotësit e tij (Menaxhimi i mjedisit urban)*
2. *Cilësia e ujit dhe ndotësit e tij (Menaxhimi i mjedisit rural)*
3. *Cilësia e dherave dhe ndotësit e tyre (Tokat/bujqësia dhe mjedisi)*

IV. Konferencat e Seksionit të Shkencave të Ekonomisë

Përgjegjës: Ardiana GASHI (Prishtinë), Adrian HARRI (SHBA), Abdilmenaf BEXHETI (Tetovë).

Bashkëpunëtorë: Mimoza KOKA (Tiranë), Avdullah HOTI (Prishtinë), Lindita KOMANI (Austri).

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: ekonomia09@alb-shkenca.org

Temat e simpoziumeve:

1. *Metodologjia e kërkimit shkencor në fushën e biznesit dhe ekonomisë*
2. *Efekti i krizës globale financiare*
3. *Cilësia e arsimit të lartë*
4. *Sistemi bankar dhe financiar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni*
5. *Zhvillimi i biznesit në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni: Kreativiteti dhe inovacioni*

V. Konferencat e Seksionit të Shkencave të Natyrës

Përgjegjës: Robert MAGARI (SHBA), Kasamedin ABDULLAHU (Tetovë),

Bashkëpunëtorë: Arben MERKOÇI (Spanjë), Bajram BERISHA (Gjermani), Burim KAMISHI (Prishtinë), Lluka Qafoku (Tiranë), Fatos YLLI (Tiranë), Jahja KOKAJ (Kuvajt), Sevdije GOVORI (Tetovë), Petrit ZORBA (Tiranë).

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: natyra09@alb-shkenca.org

Temat e simpoziumeve:

1. *Arritje shkencore në fizikë, matematikë dhe astronomi*
2. *Arritje shkencore në kimi, biokimi dhe biologji*
3. *Zbatime të shkencave të natyrës*

VI. Konferencat e Seksionit të Shkencave të Mjekësisë

Përgjegjës: Naim SHABANI (Gjermani), Nexhbedin KAHRIMANI (Tetovë),

Bashkëpunëtorë: Fatos OLLDASHI (Tiranë), Denisa SYLEJMANI (Strugë), Isuf KALO (Tiranë), Naser RAMADANI (Prishtinë), Ramadan JASHARI (Belgjikë).

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: mjekesia09@alb-shkenca.org

Temat e simpoziumeve:

Temat e simpoziumeve në këtë konferencë do të përcaktohen pas marrjes së përmbledhjeve të prezantimeve. Do të pranohen përmbledhje me tema nga të gjitha fushat e këtij seksioni (mjekësi, stomatologji dhe farmaci).

VII. Konferencat e Seksionit të Shkencave Inxhinierike dhe të Teknologjisë së Informacionit.

Përgjegjës: Musa RIZAJ (Prishtinë), Murtezan ISMAILI (Tetovë).

Bashkëpunëtorë: Besnik DOBI (Tiranë), Eshref JANUZAJ (Gjermani), Mentor HAMITI (Tetovë), Nebi CAKA (Prishtinë), Petraq PAPAJOJGJI (SHBA),

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: teknologjia09@alb-shkenca.org

Temat e simpoziumeve:

1. *Inxhinieria dhe zhvillimi i institucioneve shkencore hulumtuese*
2. *Inxhinieria dhe bashkëpunimi me ndërmarrësin*
3. *Inxhinieria dhe mjedisi*
4. *Teknologjia e informacionit, informatika*

.....

VIII. Konferencat e Seksionit të Shkencave Shoqërore

Përgjegjës: Lulzim DRAGIDELLA (Gjermani), Miqereme RUSI (Tetovë), Vesel MEMEDI (Tetovë), Mirela BOGDANI (Angli), Albert NIKOLLA (Tiranë).

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: shoqeria09@alb-shkenca.org

Temat e simpoziumeve:

Temat e simpoziumeve në këtë konferencë do të përcaktohen pas marrjes së përmbledhjeve të prezantimeve. Do të pranohen përmbledhje me tema nga të gjitha fushat e shkencave politiko-shoqërore.

.....

IX. Konferenca e projekteve ndërkombëtare

Përgjegjës: Murtezan ISMAILI (Tetovë), Arben MERKOÇI (Spanjë), Nikolla P. QAFOKU (ShBA), Roza ALLABASHI (Austri).

Kontakti dhe dërgimi i punimeve: projekte09@alb-shkenca.org

.....

FORMULAR 1: Shablloni i përmbledhjes/abstraktit

Formati i faqes: A4.

Margjinat: lart e poshtë 2 cm; djathtas e majtas 2.5 cm

Titulli i punimit në shqip dhe në anglisht (16pt Times New Roman, bold, në qendër)

EMRAT E AUTORËVE

Me shkronja të mëdha, 12pt Times New Roman, në qendër

Departamenti dhe universiteti: 12pt Times New Roman, në qendër

Adresa fizike: 12pt Times New Roman, në qendër

Adesa elektronike (për komunikim): 12pt Times New Roman, në qendër

Përmbledhja: Teksti me 150-250 fjalë, 11pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy anët), ose *Abstract (anglisht):* Teksti me 150-250 fjalë, 11pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy anët

Fjalët çelës: 5-7 fjalë, 11pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy anët ose *Keywords (anglisht):* 5-7 fjalë, 11pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy anët.